

UDHËZIME PËR PROCEDURËN E MBROJTJES NDËRKOMBËTARE NË **IRLANDË**

IRLANDEZ
POLITIKA
REFUGJAT
STATUS
TË DREJTA PYETJE
MBROJTJE
NATYRALIZIM
IMIGRIM
PROCEDURA
LEGJISLACION
PROCEDURA
DETYRIME
NDALIMI
RIBASHKIM
FAMILJE

Rreth nesh

Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (United Nations High Commissioner for Refugees, UNHCR) është agjencia e Kombeve të Bashkuara e cila ka mandatin për të mbrojtur njerëzit që janë të detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre dhe të gjejnë siguri në shtete të tjera. Zyra kombëtare e UNHCR-së në Irlandë punon që të mbrojë të drejtat dhe mirëqenien e refugjatëve, azilkërkuesve dhe njerëzve pa shtetësi në Irlandë përmes udhëzimeve, trajnimit dhe mbështetjes nga autoritetet dhe promovimit të standardeve më të mira ndërkombëtare në legjislacion, politikë dhe procedura. Ne gjithashtu ofrojmë, në disa raste, ndihmë, mbështetje ose këshillim individual për refugjatë, azilkërkues ose persona pa shtetësi.

Në dhjetor 2016, një ligj i ri i quajtur **Akti i Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015 (International Protection Act 2015)** hyri në fuqi në Irlandë. Ai krijon një procedurë të vetme të re mbrojtjeje për shqyrtimin e aplikimeve të mbrojtjes ndërkombëtare në Irlandë. Kjo broshurë informacioni mundëson një pasqyrë të ndryshimeve kryesore në ligjin e ri dhe procesin e ri të azilit dhe synon të ndihmojë personat që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë dhe ata që punojnë me kërkuesit e azilit.¹

Organet vendimmarrëse

Këto janë organizatat që do të shqyrtojnë kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare.

Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare (International Protection Office, IPO)

IPO, një zyrë brenda Shërbimit Irlandez të Natyralizimit dhe Imigrimit (Irish Naturalisation and Immigration Service, INIS), është përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve të mbrojtjes ndërkombëtare. Pavarësia e marrjes së vendimeve të oficerëve të IPO mbi mbrojtjen ndërkombëtare është e mbrojtur nga ligji irlandez. Për të kërkuar azil në Irlandë, përveç një pike të hyrjes, duhet të aplikoni personalisht te IPO. Ajo ka zëvendësuar Zyrën e Komisionerit të Aplikimeve nga Refugjatët (Refugee Applications Commissioner, ORAC) në fillim të vitit 2017. Për të mësuar më shumë, ju lutemi shkoni këtu: www.ipo.gov.ie

Gjykata e Apeleve për Mbrojtje Ndërkombëtare (International Protection Appeals Tribunal, IPAT)

IPAT është një Gjatë e pavarur. Ajo shqyrton apelet nga personat për të cilët IPO ka rekomanduar të mos marrin mbrojtje ndërkombëtare (statusin e refugjatit ose mbrojtjen e përkohshme). Ajo ka zëvendësuar Gjykatën e Apeleve të Refugjatëve (Refugee Appeals Tribunal, RAT) në fillim të vitit 2017. Për të mësuar më shumë, ju lutemi shkoni këtu: www.protectionappeals.ie

¹ **Mospranim:** Kjo broshurë është vetëm për qëllime informacioni, nuk jep këshilla ligjore dhe është në vartësi ndryshimi. Për më shumë informacion ju lutemi shikoni Broshurën informative të Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare për aplikantë për mbrojtje ndërkombëtare www.ipo.gov.ie

1 Proces me një Procedurë të Vetme

Ndryshimi më i rëndësishëm i prezantuar nga Akti i Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015 është një procedurë e re e vetme për shqyrtimin e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare. Kjo do të thotë se statusi i refugjatit, mbrojtja e përkohshme dhe leja e qëndrimit do të shqyrtohen së bashku në të njëjtin proces. Kjo duhet të shmangë vonesa të zgjata në procedurën e azilit.

**Statusi i
Refugjatit**

**Mbrojtje e
përkohshme**

**Leja e
Qëndrimit**

Proces me një Procedurë të Vetme

2 Procesi i Aplikimit

Diagrami mundëson një pasqyrë të procesit të ri të aplikimit në Irlandë dhe duhet të lexohet bashkë me tekstin poshtë secilit hap. Diagrame më të detajuara gjenden mbrapa kësaj flete informacioni.

HAPI 1

Aplikimi në **Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPO)**

HAPI 2

Intervista Paraprake

HAPI 3

Pyetësori

HAPI 5

Vendimi

HAPI 4

Intervista Personale

HAPI 6

Nëse nuk është i suksesshëm apeloni te **Gjykata e Apelit për Mbrojtje Ndërkombëtare**

HAPI 7

Nëse apelimi nuk është i suksesshëm rishikoni Vendimin e Lejes së Qëndrimit

Nëse është i suksesshëm, ju merrni

Statusin e Refugjatit, Mbrojtje e përkohshme ose Leje e Qëndrimit

Hapi 1 Aplikimi për Mbrojtje Ndërkombëtare

Mund të kërkonti mbrojtje ndërkombëtare ose në kufijtë e Shtetit ose kur të jeni brenda në Shtet te IPO. Mund të kërkonti mbrojtje ndërkombëtare për veten tuaj ose për fëmijën në ngarkim nën moshën 18 vjeçare. Nëse fëmijët tuaj kanë lindur brenda shtetit në fjalë ose hyjnë ndërkohë që janë në procedurën e mbrojtjes, ata do jenë automatikisht pjesë e kërkesës tuaj, përveç rasteve kur mund të jenë shtetas të Irlandës. Si aplikues me fëmijë, është e rëndësishme të ngrini shqetësime lidhur me mbrojtjen e fëmijës po aq sa për veten tuaj gjatë procedurës.

Tusla, Agjencia e Fëmijës dhe Familjes, mund të kërkojë mbrojtje ndërkombëtare për fëmijët e pashoqëruar nën kujdesin e tyre.

Hapi 2 Intervista Paraprake

Nëse ju kërkonti mbrojtje ndërkombëtare në kufi të Shtetit, si p.sh. në aeroport ose port bregdetar, një oficer imigracioni dhe/ose një oficer i IPO mund t'ju intervistojë. Kjo do të jetë me qëllim mbledhje informacioni paraprak, si identiteti, shteti i origjinës, rruga që keni përshkuar për në Irlandë dhe të dhëna të përgjithshme mbi të cilat ju kërkonti mbrojtje ndërkombëtare. Nëse kjo intervistë paraprake nuk është kryer në kufi të Shtetit, atëherë do të kryhet në IPO.

Intervista paraprake gjithashtu do të shqyrtojë nëse aplikimi juaj është i pranueshëm. Kjo do të thotë se një oficer i IPO do të vendosë nëse ju mund të aplikoni për azil në Irlandë. Kjo mund të mos ndodhë nëse ju është garantuar statusi i refugjatit ose mbrojtja e përkohshme në një tjetër Shtet Anëtar të BE-së, ose nëse një shtet tjetër jashtë BE-së ju ka garantuar statusin e refugjatit dhe do t'ju lejojë të ktheheni aty ku do të jeni të mbrojtur.

Çfarë ndodh nëse aplikimi im është i papranueshëm?

Do të merrni një vendim të arsyetuar nga IPO i cili do të përfshijë një limit kohor për paraqitjen e një apelimi te IPAT. Apelimi në IPAT do të bëhet vetëm me shkrim.

Nëse intervista juaj paraprake ka ndodhur në kufi të Shtetit, ju do të drejtoheni te godinat e IPO. Në IPO, ju dhe personit që varet nga ju do t'ju merren shenjat e gishtave dhe do të fotografoheni. Ky informacion merret për të përcaktuar identitetin tuaj dhe për të parë nëse Rregullorja e Dublinit aplikohet në rastin tuaj.

Pastaj do t'ju lëshohet një certifikatë e përhershme banimi e cila tregon se ju keni lejen e qëndrimit në Irlandë gjatë aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare. Kjo nuk është kartë zyrtare identiteti, por duhet ta mbani gjithmonë me vete. Ajo mund të rinovohet gjatë procedurës së mbrojtjes.

Hapi 3 Pyetëtori

Një oficer i IPO do t'ju pajisë me një broshurë informacioni mbi procesin e procedurës së vetme dhe një pyetësor për ta plotësuar dhe për ta kthyer në IPO. Është shumë e rëndësishme ta lexoni broshurën e informacionit përpara plotësimit të pyetësorit dhe të kërkonti ndihmë juridike.

Është e rëndësishme ta plotësoni pyetësorin dhe të paraqisni informacion të saktë lidhur me nevojat tuaja për mbrojtje ndërkombëtare. Nëse nuk kuptoni pjesë të pyetësorit, kërkonti ndihmë nga avokati juaj.

Ku të jetë e mundur, pyetëtori duhet të kthehet brenda 20 ditësh pune, p.sh. 4 javë. Kjo e ndihmon IPO t'i shqyrtojë aplikimet në mënyrë sa më efikase që të jetë e mundur. Nëse ju duhet më shumë kohë për plotësimin e pyetësorit ose ju të konsultoheni me një avokat, IPO i siguron aplikuesit se do t'ju mundësohet fleksibilitet. Nëse juve personalisht ju duhet më shumë kohë, flisni me avokatin tuaj ose kontaktoni direkt IPO për t'i informuar (Shikoni faqen 21 për informacionet e kontaktit).

Është e rëndësishme që të shtoni dokumenta mbështetës që mendoni se mund të kenë lidhje me aplikimin tuaj. Kjo përfshin informacione lidhur me aplikimin për lejen e qëndrimit.

Hapi 4 Intervista Personale

IPO do t'ju dërgojë një letër takimi për intervistën tuaj. Një përkthyes do të caktohet për ju, nëse ju e kërkonti. Nëse keni informacion dhe/ose prova shtesë që kur keni dorëzuar pyetësorin tuaj, përpikuni ta dorëzoni këtë informacion të paktën një javë përpara intervistës së caktuar.

Intervista është mundësia juaj për të paraqitur të gjitha arsyet pse ju kërkonti mbrojtje në Irlandë. Në ditën e intervistës ju lutemi kontrolloni nëse ju dhe përkthyesi e kuptoni njëri-tjetrin.

Nëse keni vështirësi të kuptoni përkthyesin, thojani këtë oficerit intervistues të IPO. Oficeri intervistues i IPO do ta ketë lexuar pyetësorin e plotësuar që më parë dhe do të jetë njohur me çështjen tuaj. Nëse keni vështirësi të kuptoni pyetjet e bëra nga oficeri intervistues i IPO, ju lutemi kërkojini t'ju përsërisë pyetjen. Ju lutemi kini parasysh që jeni të detyruar të azhurnoni Ministrin për ndryshimet e rrethanave lidhur me aplikimin e lejes së qëndrimit deri në kohën kur do të përgatitet një raport nga Ministri në lidhje me vendimin e lejes së qëndrimit.

Nëse doni të jepni informacion shtesë lidhur me aspektin e lejes së qëndrimit të aplikimit tuaj, kjo është mundësia juaj për ta bërë këtë gjë. Ju dhe avokati juaj mund të bëni parashtrime me shkrim në lidhje me aplikimin tuaj deri në dhe përfshirë ditën e intervistës.

Një proces-verbal i shkruar i intervistës do të mbahet nga oficeri intervistues i IPO. Në intervale të caktuara gjatë intervistës, intervistuesi do të ndalojë dhe do t'ju kërkojë të rishikoni shënimet e fjalëve tuaja për të bërë ndonjë qartësim ose korrigjim të nevojshëm. Pastaj do t'ju kërkojë të nënshkruani proces-verbalin e intervistës për të konfirmuar saktësinë e tij. Nëse ka diçka në intervistën e shkruar


që nuk është e saktë ose ka ndonjë pjesë që mungon në të, informoni oficerin intervistues direkt që ta qartësoni.

Avokati juaj mund të marrë pjesë në intervistë, megjithëse kjo nuk është një praktikë e zakonshme. Ai/ajo mund të bëjë parashtrime në emrin tuaj përpara intervistës. Nëse jeni një fëmijë i pashoqëruar, kujdestari ose përfaqësuesi juaj nga Tusla mund të marrë pjesë në intervistë. Intervista mund të shtyhet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, për shembull, kur jeni sëmurë. Është e rëndësishme të informoni IPO menjëherë nëse nuk merrni dot pjesë në intervistë në datën e caktuar. Intervista mund të mos kërkohet në rrethana të veçanta të kufizuara.²

Hapi 5 Vendimi IPO

Pas intervistës, IPO do të marrë në konsideratë të gjithë informacionin përkatës lidhur me rastin tuaj. Kjo përfshin proces-verbalin e intervistës dhe pyetësonin e plotësuar. Nëse nuk merret një rekomandim brenda gjashtë muajsh, ju mund të kërkoni informacion për kohën e marrjes së një vendimi nga IPO.

Rezultatet e mundshme të ndryshme për një rekomandim janë të paraqitura në tabelën më poshtë. Rekomandimi do të përfshijë një deklaratë me arsyet pse është marrë rekomandimi mbi aplikimin tuaj individual. Gjetje të caktuara në rekomandim mund të ndikojnë në kufirin kohor e çdo apelim dhe nëse lejohet apo jo seanca dëgjimore para IPAT.



² Për më shumë informacion shikoni pjesën 4.5.12 të Broshurës Informativë të Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare për aplikantë për mbrojtje ndërkombëtare.

Ju dhe avokati juaj do ta merrni rekomandimin me postë të regjistruar. Nëse IPO rekomandon që t'ju jepet statusi i refugjatit, Ministri i Drejtësisë dhe Barazisë (Ministri) do t'ju japë një deklaratë refugjati brenda disa javësh. Në rrethana shumë të kufizuara Ministri mund të refuzojë ta ndjekë rekomandimin e IPO kur aplikuesi konsiderohet se përbën rrezik për sigurinë.

Nëse ju është refuzuar statusi i refugjatit por ju është dhënë mbrojtja e përkohshme, do të keni të drejtën të apeloni te TIPAT për statusin e refugjatit. Nëse ju është refuzuar edhe statusi i refugjatit, edhe mbrojtja e përkohshme, Ministri do të vendosë nëse do t'ju japë apo jo “lejen e qëndrimit”: Sido që të jetë vendimi për të dhënë apo jo leje qëndrimi, ju do të keni të drejtën të apeloni vendimin për refuzimin e mbrojtjes ndërkombëtare nga IPAT.

Nëse ju është refuzuar statusi i refugjatit ose i mbrojtjes shtesë, ju do të merrni një kopje të proces-verbalit të intervistës dhe një deklaratë mbi të drejtën tuaj për të apeluar tek Gjykata e Apelimit të Mbrojtjes Ndërkombëtare. Gjithashtu do të merrni informacion mbi procedurën që duhet të ndiqet dhe një formular apelimi për të paraqitur një apelim të tillë. Për diagrame më të detajuara mbi rezultatet e aplikimit tuaj, ju lutemi shikoni pjesën e pasme të fletës së informacionit.

Hapi 6 **Apeloni tek Gjykata e Apelimit të Mbrojtjes Ndërkombëtare.**

Mund të apeloni një rekomandim të IPO që nuk keni të drejtë për statusin e refugjatit ose mbrojtjen e përkohshme te IPAT. Nuk ka apel i cili mund të bëhet te IPAT për refuzim të lejes së qëndrimit.

Një formular apelimi duhet të plotësohet dhe të dorëzohet te IPAT brenda afatit kohor për të cilin do të njoftoheni në letrën tuaj të rekomandimit nga IPO. Mund të kërkonit seancë dëgjimore për apelim, në varësi të konkluzionit të letrës së rekomandimit të IPO.

Do të njoftoheni kur të jetë caktuar një datë për apelin tuaj. Në ditën e seancës dëgjimore, nëse kërkohet përkthyes, ju lutemi shikoni nëse ju dhe përkthyesi e kuptoni njëri-tjetrin. Nëse keni ndonjë vështirësi në të kuptuarin e përkthyesit thojini një Anëtar të Gjykatës. Gjatë seancës dëgjimore do të jetë i pranishëm një anëtar i IPO, ju, avokati ose barristeri juaj si dhe anëtar i Tribunalit. Anëtar i Tribunalit gjithashtu mund të urdhërojë pjesëmarrjen e një dëshmitari përpara Tribunalit për të dhënë prova lidhur me disa aspekte të aplikimit për mbrojtje.

Nëse IPAT e hedh poshtë rekomandimin negativ nga IPO, Ministri do t'ju japë deklaratën përkatëse të mbrojtjes p.sh. statusin e refugjatit ose mbrojtjen shtesë.

Po sikur të marr leje qëndrimi nga IPO dhe të dëshiroj të apeloj rekomandimin për të refuzuar statusin e refugjatit apo mbrojtjen e përkohshme?

Nëse ju jepet leja e qëndrimit, ju ende mund të apeloni rekomandimin e IPO për të refuzuar mbrojtjen ndërkombëtare. Ju gjithashtu mund të regjistroni lejen tuaj të qëndrimit në zyrën tuaj lokale të regjistrimit të imigracionit.

Hapi 7 Rishikimi i lejes së qëndrimit

Nëse Ministri nuk ju ka dhënë leje qëndrimi dhe apeli juaj në IPAT nuk është i suksesshëm, atëherë Ministri do ta rishikojë vendimin për të mos dhënë leje qëndrimi kur keni paraqitur ndonjë informacion të ri që nga marrja e vendimit të parë. Ju do të merrni një formular rishikimi për lejen e qëndrimit që ta plotësoni. Ju do të keni vetëm **5 ditë pune** për të paraqitur informacione të reja në mënyrë që të siguroheni që të merrni çdo dokument që dëshironi të dorëzoni paraprakisht. Nëse rrethanat tuaja ndryshojnë në kohën ndërmjet vendimit të lejes së qëndrimit fillestare të Ministrit dhe vendimit të IPAT për ankesën tuaj dhe keni të dhëna të reja të rëndësishme për shqyrtimin e lejes së qëndrimit, ju duhet ta informoni Ministrin sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ministri gjithashtu mund të japë leje qëndrimi nëse mosmarrja e një vendimi të tillë do të rezultojë në shkeljen e ndalimit të kthimit (për më shumë informacion, shikoni **7. Pyetje të shpeshta**).

CILAT JANË TË DREJTAT E MIA?

Të drejtat tuaja përfshijnë:

Nëse jeni aplikues për mbrojtje ndërkombëtare të drejtat tuaja përfshijnë si më poshtë:

- Leje për të hyrë dhe qëndruar në Irlandë për shqyrtimin e aplikimit të mbrojtjes tuaj ndërkombëtare nga IPO dhe çdo apelim te IPAT.
- E drejta për të marrë këshillim ligjor dhe përfaqësim nga një avokat
- E drejta për t'u trajtuar me respekt, dinjitet dhe drejtësi gjatë procedurës së vetme
- E drejta për të bërë parashtrime me shkrim te Ministri për çdo gjë që lidhet me aplikimin tuaj për mbrojtje
- Përdorimi i një përkthyesi ku është e nevojshme për të siguruar komunikim
- E drejta e konfidencialitetit
- E drejta për t'u njoftuar me shkrim për intervista, vendime ose njoftime të tjera të tilla lidhur me aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare.
- E drejta për të komunikuar me UNHCR

Ndihma ligjore është e mundur nga **Bordi i Ndhmës Ligjore (Legal Aid Board, LAB)**. Ata do t'ju ofrojnë një nga avokatët e tyre ose një avokat privat që punon me ta. LAB është përkushtuar t'ju ofrojë të gjithë klientëve që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare këshillim ligjor të hershëm në të gjitha aspektet e aplikimit të tyre. Kjo mund të përfshijë një konsultë paraprake për marrjen e informacionit para se të plotësoni pyetësonin dhe një konsultë para-interviste ku do të jepen këshilla ligjore për pjesë të caktuara të kërkesës tuaj bazuar në pyetëson. **Qendra Ligjore Irlandeze e Pavarur e Këshillit të Refugjatëve (Irish Refugee Council Independent Law Centre)** ofron gjithashtu këshilla të hershme në vartësi të kapacitetit. Nëse keni fonde, mund të kërkontë shërbimin e një avokati privat.

Në varësi të rrethanave individuale të aplikimit tuaj mund të preferoni që gjatës intervistës ose seancës dëgjimore të jetë i pranishëm një përkthyes me gjini të caktuar. Është e rëndësishme t'a shprehni këtë sa më shpejt të jetë e mundur te IPO dhe/ose IPAT në mënyrë që t'a realizojnë këtë kërkesë ku të jetë e mundur.

I gjithë informacioni i mundur në lidhje me aplikimin tuaj do të trajtohet me konfidencë dhe nuk do të zbulohet tek autoritetet në shtetin tuaj të origjinës/ shtetin e vendbanimit të zakonshëm ose të përfaqësuesit e shtetit tuaj në Irlandë.

CILAT JANË DETYRIMET E MIA?

Detyrimet përfshijnë:

- Detyrën për të zbatuar ligjet e Irlandës.

Kjo do të thotë të keni respekt për ligjet dhe rregullat e Irlandës.

- Detyrën për të bashkëpunuar

Si aplikues i procedurës së vetme ju keni detyrë aktive të bashkëpunoni në shqyrtimin e aplikimit të mbrojtjes tuaj dhe në vendimin e çdo apelimi në lidhje me atë aplikim. Gjithashtu ju duhet të paraqisni sa më shpejt dhe praktikisht arsyeshëm të gjithë informacionin e nevojshëm për të provuar aplikimin tuaj dhe duhet të jeni të besueshëm. Nëse nuk bashkëpunoni mund të ketë pasoja në rezultatin e aplikimit të mbrojtjes.

Detyrime procedurale

Pjesë e detyrimit për të bashkëpunuar përfshin detyrimet e mëposhtme:

- a. Moslargimi ose përpjekja për t'u larguar nga Irlanda gjatë procedurës së vetme pa lejen e Ministrit;
- b. Informimi i Ministrit për adresën tuaj dhe ndonjë ndryshim në adresë me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur;
- c. Të pajtoheni me njoftimet për të raportuar që mund të merrni si një kërkesë për të banuar ose qëndruar në një vend ose vendndodhje specifike në Irlandë dhe/ose raportuar në intervale të caktuara tek oficeri i imigrimit, ose në komisariatet e caktuara të policisë (Garda);
- d. Duke treguar emrin, adresën, kombësinë dhe numrin e ID të personit në certifikatën e banimit të përkohshëm në korrespondencat me IPO ose IPAT;
- e. Të qenit i sinqertë në lidhje me kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare dhe plotësimin e pyetësorit tuaj me informacionin përkatës për të shqyrtuar kërkesën tuaj;
- f. Mbajtja e të gjitha kopjeve të dokumentacionit që ju është dhënë ose që ju i keni dhënë IPO dhe IPAT.

A mund të punoj ndërkohë që aplikimi im për mbrojtje ndërkombëtare është në shqyrtim?

Nëse nuk keni marrë një vendim rreth aplikimit për mbrojtje nga IPO brenda 6 muajve, dhe nëse ju nuk keni shkaktuar vonesa me veprimet tuaja, atëherë ju mund të aplikoni për leje për punë. Për më shumë informacion, shiko: www.inis.gov.ie

4 Informata të tjera të vlefshme

Prioritizimi

Disa lloje të aplikimeve mund të prioritizohen nga IPO. Kjo do të thotë që aplikimet e tilla do të planifikohen për intervistë sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo nuk e paracakton vendimin që duhet të merret në raste të tilla ose nuk jep ndonjë garanci shtesë kur merret vendimi në raste të tilla.

Rastit tuaj mund t'i jepet prioritet për shkaqe të caktuara, duke përfshirë nëse jeni mbi moshën 70 vjeç (dhe jo si pjesë e një grupi familjar), një fëmijë i pashoqëruar, për shkaqe serioze shëndetësore ose për shkak të vendit tuaj të shtetësisë (Siria, Eritrea, Irak, Afganistan, Iran, Libi dhe Somali).

IPO, në konsultim me UNHCR, ka lëshuar një njoftim mbi prioritizimin e grupeve të caktuara të aplikimeve, të cilin mund ta gjeni këtu: http://www.ipo.gov.ie/en/ipo/pages/prioritisation_applicants

Tërheqja

Ju jeni të lirë të tërhiqni aplikimin tuaj të mbrojtjes ose të apeloni në çdo kohë para se të përgatitet një raport për aplikimin tuaj nga IPO ose një vendim të marrë nga IPAT. Është e rëndësishme që të kërkonti këshilla ligjore para se të tërhiqni kërkesën tuaj për të kuptuar plotësisht pasojat e një tërheqjeje të tillë për veten dhe për personat që varen nga ju. Pasi të tërhiqet, shqyrtimi i kërkesës suaj do të përfundojë dhe Ministri do të refuzojë t'ju japë statusin e refugjatit ose mbrojtjen shtesë.

Kthimi vullnetar

Ju keni mundësinë të ktheheni vullnetarisht në vendin tuaj të origjinës / banimit të përhershëm në çdo fazë të procedurës së vetme. Nëse vendosni të ktheheni vullnetarisht, Organizata Ndërkombëtare për Migrim (International Organisation for Migration, IOM) mund t'ju ofrojë mbështetje dhe këshilla, duke përfshirë ndihmën financiare për udhëtimin tuaj. Njësia e kthimit vullnetar të INIS-it gjithashtu mund t'ju ofrojë ndihmë.

Për të përfituar nga kthimi vullnetar gjatë procesit, ju duhet ta tërhiqni kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare me IPO ose ta tërhiqni apelimin tuaj me IPAT. Ministri do t'ju informojë gjithashtu për mundësinë e kthimit vullnetar në vendin tuaj të origjinës / vendbanimit të përhershëm në fund të procesit, nëse ju refuzohet mbrojtja ndërkombëtare në Irlandë dhe nuk ju jepet leja e qëndrimit. Për të mësuar më shumë, ju lutemi shihni: <https://www.youtube.com/watch?v=eX7GarY2rUE>

Rregullorja e Dublinit e BE-së

Rregullorja e Dublinit e BE-së është një instrument ligjor që përcakton se cili Shtet Anëtar është përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare. Kur bëni kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, IPO do t'ju ofrojë një fletëpalosje informuese mbi Rregulloren e Dublinit të BE-së. Është e rëndësishme që ta lexoni me kujdes këtë broshurë informacioni pasi mund të ketë arsye pse një Shtet tjetër Anëtar është përgjegjës për aplikimin tuaj, duke përfshirë nëse anëtarët e familjes tuaj janë të pranishëm në një Shtet Anëtar të BE-së. Nëse aplikimi juaj bie nën Rregulloren e Dublinit të BE-së, ju do të merrni një fletëpalosje informuese mbi procedurën e Dublinit dhe implikimet e saj për rastin tuaj individual.

Aplikimi i mëvonshëm për mbrojtje ndërkombëtare

Nëse ju është refuzuar statusi i refugjatit dhe mbrojtjes shtesë dhe kërkesa juaj është mbyllur, kërkohet miratimi i Ministrit nëse dëshironi të bëni një kërkesë të dytë ose të mëtejshme për mbrojtjen ndërkombëtare në Irlandë. Ju mund të bëni një kërkesë me shkrim te Ministri duke kërkuar miratim për një kërkesë të mëvonshme. Faktorët që do të konsiderohen përfshijnë:

- a. Që nga aplikimi i mëparshëm janë të disponueshme informacione të reja, gjë që e bën shumë më të mundshme që ju të kualifikoheni për mbrojtje ndërkombëtare dhe nuk keni mundur ta siguronit atë informacion në një fazë më të hershme të aplikacionit të mëparshëm;
- b. Nëse kërkesa juaj e mëparshme u tërhoq ose konsiderohet e tërhequr kur ishit, jo për fajin tuaj, të pamundur për të ndjekur aplikimin e mëparshëm.

Nëse Ministri refuzon të japë pëlqimin për një kërkesë të mëvonshme për mbrojtje ndërkombëtare, do t'ju jepet një vendim i arsyeshëm të cilin mund ta apelonit në IPAT.

Shqyrtimi gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor është një mënyrë që Gjykata e Lartë të mbikëqyrë organet administrative dhe Gjykatat, duke përfshirë IPO dhe IPAT për të siguruar që ato të marrin vendimet në mënyrë të duhur dhe në përputhje me ligjin. Shqyrtimi gjyqësor nuk është një apel. Ai lejon që aplikuesi, në konsultim me avokatin e tij/të saj, të kërkojë që vendimi IPO dhe/ose IPAT të shqyrtohet në mënyrë gjyqësore nga Gjykata e Lartë sipas ligjit administrativ të Irlandës, për shembull kur ka pasur një gabim ligjor në procesin e përcaktimit lidhur me aplikimin e tyre. Avokati juaj do t'ju këshillojë nëse kjo zbatohet në lidhje me aplikimin tuaj. Është e rëndësishme të theksohet se një gjykatë që bën shqyrtimin gjyqësor nuk mund të rekomandojë një vendim pozitiv për mbrojtjen ndërkombëtare, por mund të kërkojë që IPO ose IPAT të marrë një vendim të ri duke marrë parasysh gjetjet ligjore të Gjykatës. Procedimet e

shqyrtimit gjyqësor mund të merren edhe kundër Ministrit të Drejtësisë dhe Barazisë. Ju lutemi flisni me avokatin tuaj për të përcaktuar nëse ndonjë nga këto opsione duhet të konsiderohet në rastin tuaj.

Ndalimi

Aplikuesit në përgjithësi nuk mbahen në ndalim gjatë procedurës së mbrojtjes në Irlandë. Sidoqoftë, në rrethana të caktuara, një aplikues mund të arrestohet pa urdhër nga një oficer i imigracionit ose anëtar i Garda Síochána (policisë) nëse ata dyshojnë në mënyrë të arsyeshme se aplikuesi:

- I. paraqet kërcënim për sigurinë publike ose për rendin publik në shtet;
- II. ka kryer një krim serioz jo-politik jashtë Irlandës;
- III. nuk ka bërë përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar identitetin e tij/saj;
- IV. synon të largohet nga Irlanda dhe pa autorizim të ligjshëm të hyjë në një vend tjetër;
- V. ka vepruar ose ka ndërmend të veprojë në një mënyrë që do të dëmtonte sistemin për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare personave në Shtet, ose çdo marrëveshje që lidhet me Zonën e Përbashkët të Udhëtimit, ose
- VI. pa justifikim të arsyeshëm, ka shkatërruar dokumentin e tij/saj të identitetit ose udhëtimit, ose është ose ka qenë në posedim të një dokumenti identifikimi të falsifikuar, të ndryshuar ose të zëvendësuar.

Një aplikues i arrestuar në këto rrethana mund të çohet dhe të mbahet në vende të përcaktuara për këtë qëllim në ligj. Fëmijët, të përcaktuar si nën moshën 18 vjeç, nuk mund të ndalohen sipas këtij ligji.

A mund të aplikoj për mbrojtje ndërkombëtare nëse mbahem në paraburgim apo ndalim policor?

Ju mund të aplikoni për mbrojtje ndërkombëtare nëse jeni i ndaluar ose paraburgosur. Ju duhet të informoni Guvernatorin e burgut ose Garda në komisaratin e policisë ku jeni ndaluar sa më shpejt që të jetë e mundur nëse dëshironi të bëni një kërkesë. Rasti juaj do të prioritizohet nëse qëndroni në paraburgim gjatë shqyrtimit të aplikimit tuaj.

A do të rishikohet ndalimi im nga një Gjykatë?

Nëse ju jeni të ndaluar në bazë të arsyeve të lartpërmendura ju do të silleni përpara një gjyqtari të Gjykatës së Qarkut në zonën ku ju jeni ndaluar sa më shpejt që të jetë e mundur. Gjyqtari i Gjykatës së Qarkut do të shqyrtojë përdorimin e ndalimit bazuar në rrethanat individuale të rastit tuaj.

Të drejtat e mia si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare

Nëse ju jepet një deklaratë e statusit të refugjatit ose mbrojtje e përkohshme ju do të keni të drejtën:

- E lejes së qëndrimit në Irlandë për një periudhë të caktuar jo më pak se 3 vjet;
- Të kërkonti dhe të hyni në punë, të angazhoheni në ndonjë biznes, tregti ose profesion;
- E qasjes në arsim dhe trajnim në të njëjtën mënyrë si qytetarët irlandezë;
- Të merrni të njëjtat ndihma mjekësore dhe ndihma sociale si qytetarët irlandezë;
- Të merrni të njëjtat të drejta për të udhëtuar për në Irlandë ose nga Irlanda si ato për të cilat qytetarët irlandezë kanë të drejtë (megjithatë, ju lutem të keni parasysh që mund të kërkonti vizë për të hyrë në një vend tjetër).
- Të kërkonti në Ministri, brenda një viti nga marrja e statusit të refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, për leje që disa anëtarë të familjes tuaj të hyjnë dhe banojnë në Irlandë me ju.

Si mund të aplikoj për një dokument udhëtimi?

Ju mund të aplikoni te Ministri për të marrë një dokument udhëtimi duke plotësuar një formular aplikimi. Gjithashtu kërkohet pagesa e një tarife prej €80. Ministri nuk do të lëshojë një dokument udhëtimi nëse personi që aplikon për të nuk ka ofruar informacionin e nevojshëm për të shqyrtuar kërkesën, personi që aplikon për të ka mbrojtje të përkohshme dhe mund të marrë një pasaportë kombëtare ose Ministri konsideron se nuk është në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose rendit publik ose do të ishte në kundërshtim me politikën publike.

Kam leje qëndrimi. A mund të aplikoj për një dokument udhëtimi?

Nëse nuk ju është dhënë statusi i refugjatit ose i mbrojtjes së përkohshme, por ju është dhënë leja e qëndrimit në Irlandë, duhet të aplikoni për një pasaportë në ambasadën e vendit tuaj. Në disa raste të jashtëzakonshme, personave të cilëve u është dhënë leja e qëndrimit dhe që nuk kanë pasaportë, mund t'ju lëshohet një dokument alternativ udhëtimi nga Ministri për Drejtësi dhe Barazi.

Të drejtat e refugjatëve dhe përfituesve të mbrojtjes së përkohshme janë gjerësisht të njëjta, përveç se si refugjat ju keni të drejtën të merrni dokumentin e udhëtimit të refugjatëve. Përfituesi i mbrojtjes së përkohshme do të marrë vetëm një dokument udhëtimi nga INIS ku personi nuk është në gjendje të marrë një pasaportë kombëtare nga vendi i origjinës. Statusi i refugjatëve është gjithashtu një status i njohur ndërkombëtarisht në bazë të Konventës së OKB-së për Refugjatët të vitit 1951 dhe Protokollit të saj. Refugjatët mund të aplikojnë për shtetësi irlandeze pas tre vjetësh, ndërsa përfituesit e mbrojtjes së përkohshme duhet të presin pesë vjet.

Nëse ju refuzohet statusi i refugjatit dhe mbrojtjes së përkohshme, por ju jepet leja e qëndrimit, kjo leje do të jetë në përputhje me Pjesën 4 të Ligjit të Imigracionit të vitit 2004 (Immigration Act 2004). Leja e dhënë mund t'i nënshtrohet kushteve të caktuara. Këto përfshijnë kohëzgjatjen e dhënies së lejes dhe nëse lejoheni të angazhoheni në punësim, biznes ose profesion në Shtet. Leja e qëndrimit mund të rinovohet kur të mbarojë, megjithatë, kohëzgjatja dhe kushtet e përcaktuara në të mund të rishikohen në çdo kohë.

Një person që ka leje qëndrimi nuk ka të drejtën e bashkimit familjar sipas Ligjit të Mbrojtjes Ndërkombëtare. Ai/Ajo mund të aplikojë për bashkim familjar përmes procedurave të rregullta të imigracionit, megjithatë do të zbatohen kritere dhe konsiderata të ndryshme.

Bashkimi familjar

Nëse ju jepet një deklaratë për statusin e refugjatit ose mbrojtjen e përkohshme, ju mund të aplikoni brenda 12 muajve nga marrja e asaj deklaratë te Ministri për leje për disa anëtarë të familjes tuaj ose të hyjnë dhe të banojnë në Irlandë me ju ose nëse ata janë tashmë në Irlandë, për të banuar dhe për të qëndruar me ju këtu.

Një anëtar i familjes do t'i jepet leja e qëndrimit në Irlandë për një periudhë të caktuar jo më pak se 1 vit dhe në rast të rinovimit, jo më pak se 2 vjet.

Kush është përcaktuar si një anëtar i familjes për qëllimet e bashkimit familjar?

Nëse jeni një aplikues i rritur, anëtarët e familjes tuaj përkufizohen si

- (i) bashkëshorti/ja ose partneri(ja) juaj, nëse martesë ose partneriteti civil ka qenë në fuqi kur keni aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare;**
- (ii) fëmija juaj, për sa kohë që është nën moshën 18 vjeç dhe beqar në kohën kur keni aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare.**

Unë jam një fëmijë i pashoqëruar. Kush është përcaktuar si një anëtar i familjes për mua për qëllimet e ribashkimit familjar?

Prindërit tuaj dhe vëllezërit e motrat tuaja, nëse janë nën moshën 18 vjeç dhe të pamartuar. Familja juaj përkufizohet nga koha kur aplikoni për bashkim familjar.

Si mund të aplikoj për bashkim familjar?

Ju mund të aplikoni për bashkim familjar, pasi t'ju jepet një deklaratë e statusit të refugjatit ose mbrojtjes së përkohshme, me shkrim te Family Reunification Unit, Irish Naturalisation and Immigration Service (Njësia për Bashkimin Familjar, Shërbimi Irlandez i Natyralizimit dhe Imigracionit), 13/14 Burgh Quay, Dublin 2.

Procedura e aplikimit për bashkimin familjar

Ju duhet të aplikoni për bashkim familjar brenda 12 muajsh nga marrja e deklaratës së statusit tuaj të refugjatit ose mbrojtjes shtesë nga Ministri. Për shembull, nëse ju është dhënë një deklaratë e statusit të refugjatit më 1 mars 2017, ju duhet të aplikoni për bashkim familjar para datës 1 mars 2018.

Ju duhet të aplikoni me shkrim në Njësinë e Bashkimit Familjar, INIS dhe të jepni informacionin e mëposhtëm:

- Emrin tuaj, numrin e ID-së dhe adresën tuaj;
- Datën në të cilën ju është dhënë statusi i refugjatit ose mbrojtja shtesë nga Ministri;
- Për secilin anëtar të familjes: emri i tyre, marrëdhënia me ju, data e lindjes, kombësia dhe adresa e tanishme.

Mund të jetë e dobishme të sigurohet gjithashtu një kopje e deklaratës tuaj të statusit të refugjatit ose të mbrojtjes shtesë në korrespondencën. Pas këtij aplikimi do të merrni një pyetësor për të plotësuar nga Njësia e Bashkimit Familjar. Në këtë fazë do t'ju kërkohet gjithashtu të dorëzoni dokumente origjinale në lidhje me anëtarët e familjes tuaj, siç janë certifikatat e lindjes, letërnjoftimet kombëtare dhe pasaportat, së bashku me dy fotot e nënshkruara me ngjyra të pasaportave. Ju gjithashtu mund t'ju duhet të paraqisni dokumentin tuaj të udhëtimit dhe dëshminë dokumentare të adresës suaj të tanishme. Në varësi të rrethanave tuaja individuale, ju gjithashtu mund t'ju duhet të dorëzoni një certifikatë martesë nëse kërkoni bashkim familjar me bashkëshortin apo bashkëshorten ose informata të tjera të vlefshme ose dëshmi të dokumentuara.

Sapo të keni plotësuar dhe dorëzuar pyetësorin tuaj, Njësia e Bashkimit Familjar do ta shqyrtojë kërkesën tuaj dhe ju do të merrni një letër vendimi. Nëse bashkimi familjar miratohet, do të merrni në letrën e vendimit dhënien e lejes, një datë me të cilën anëtarët tuaj të familjes duhet të hyjnë dhe/ose banojnë në Shtet. Është e rëndësishme që të organizoni udhëtimin e tyre para kësaj date, sepse nëse anëtarët e familjes tuaj nuk hyjnë në Irlandë para ose në atë datë, atëherë leja e ribashkimit familjar pushon së qeni në fuqi.

Unë jam një anëtar i familjes i cili kohët e fundit ka marrë miratimin për t'u bashkuar me anëtarin e familjes sime në Irlandë. Cilat janë të drejtat e mia?

Ju keni leje për të hyrë dhe/ose banuar në Irlandë për një periudhë jo më pak se një vit dhe në rastin e rinovimit, jo më pak se dy vjet. Si anëtar i familjes, ju keni të njëjtat të drejta si sponsori juaj, me kusht që mbrojtja ndërkombëtare e sponsorit të jetë në fuqi dhe ju jeni banor në Shtet.

6 Dispozitat e Përkohshme

Disa njerëz do të kenë aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare para fillimit të Ligjit të Mbrojtjes Ndërkombëtare më 31 dhjetor 2016. Janë bërë disa organizime për transferimin e aplikacioneve të tyre për statusin e refugjatëve dhe mbrojtjen shtesë nga Zyra e Komisionerit të Aplikacioneve për Refugjatë (Office of the Refugee Applications Commissioner, ORAC) dhe apele të caktuara nga Gjyata e Apelimit të Refugjatëve (RAT) tek IPO e re. Këta aplikues duhet të kenë marrë një letër individuale nga IPO që iu shpjegon atyre organizimet e transferimit për aplikimet e tyre.

Diagramet më poshtë paraqesin kategoritë kryesore të rasteve të transferuara në IPO. Është e rëndësishme të theksohet se kutitë në të majtë tregojnë aplikimet që janë bërë para datës 31 dhjetor 2016. Më shumë informacione janë në dispozicion në **shënimet e informacionit të IPO për organizimet e përkohshme**: http://ipo.gov.ie/en/IPO/Pages/Transitional_Arrangements Ju lutemi këshillohuni me avokatin tuaj nëse keni nevojë për këshilla të mëtejshme lidhur me kërkesën tuaj.

Unë kërkoja statusin e refugjatit në ORAC para 31 dhjetorit 2016 dhe nuk kam marrë një rekomandim për rastin tim

Dosja juaj do të transferohet në IPO për të shqyrtuar nevojat tuaja ndërkombëtare të mbrojtjes. Kjo do të thotë që ju do të plotësoni një pyetësor të ri dhe do të keni një intervistë të re brenda një procedure të vetme.

Kërkesa ime për statusin e refugjatit ishte në apelim në RAT para datës 31 dhjetor 2016, por unë nuk kam marrë një vendim nga Gjykata.

Dosja juaj do të transferohet në IPO për shqyrtimin e të drejtës suaj vetëm për mbrojtje plotësuese. Gjithashtu do të keni një pyetësor të ri dhe intervistë vetëm për mbrojtjen plotësuese. Nëse IPO refuzon kërkesën tuaj për Mbrojtje plotësuese, Ministri do të marrë në konsideratë nëse duhet të jepet leja e qëndrimit. Nëse apeloni për refuzimin e mbrojtjes shtesë, ankesa juaj do të përfshijë apelimin e statusit të refugjatit i cili është ruajtur, kështu që të dyja ankesat do të merren së bashku, pra statusi i refugjatit dhe mbrojtja e përkohshme.

Kam aplikuar për Mbrojtje e përkohshme në ORAC para datës 31 dhjetor 2016, por shqyrtimi nuk ka filluar ende mbi aplikimin tim.

Dosja juaj do të transferohet në IPO për shqyrtimin e të drejtës suaj vetëm për mbrojtje plotësuese. Gjithashtu do të keni një pyetësor të ri dhe intervistë vetëm për mbrojtjen plotësuese. Rekomandimi që refuzon statusin e refugjatit nga ORAC dhe vendimi i RAT (nëse është e aplikueshme) do të mbesë në fuqi. Nëse IPO refuzon kërkesën tuaj për mbrojtje plotësuese, Ministri do të marrë në konsideratë nëse duhet të jepet leja e qëndrimit. Ju gjithashtu mund të apeloni për refuzimin e mbrojtjes shtesë nga IPO te IPAT.

Kërkesa ime për Mbrojtje e përkohshme ishte në apel për RAT para datës 31 dhjetor 2016. Çfarë do të ndodhë me kërkesën time?

IPAT, e cila ka zëvendësuar RAT, do të marrë një vendim vetëm për ankesën e mbrojtjes shtesë. Ju pastaj do të keni të drejtë të aplikoni me shkrim te Ministri i Drejtësisë dhe Barazisë për "leje qëndrimi" sipas nenit 3 të Ligjit të Imigracionit 1999. Bazat e vendimeve të tilla ndryshojnë në disa aspekte ndaj konsideratave të "lejes së qëndrimit" të përcaktuara në Ligjin Ndërkombëtar të Mbrojtjes 2015. Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni me përfaqësuesin tuaj ligjor.

Kam bërë një apel për RAT mbi një vendim të Rregullores së Dublinit para datës 31 dhjetor 2016. Çfarë do të ndodhë me kërkesën time?

IPAT, e cila zëvendësoi RAT, do të marrë një vendim vetëm për apelin e vendimit të Rregullores së Dublinit. Nëse ankesa juaj do të jetë e suksesshme atëherë kërkesa juaj do të shqyrtohet në Irlandë përmes procedurave të rregullta.

7 Pyetjet më të shpeshta:

Pyetje

Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare?

Përgjigje

Mbrojtja ndërkombëtare është një frazë e përdorur zakonisht në ligjin e BE-së e cila i referohet statusit të refugjatëve dhe mbrojtjes shtesë. Një person që kërkon azil në Irlandë është duke kërkuar mbrojtje ndërkombëtare nga persekutimi ose lëndime të rënda në vendin e tyre.

Pyetje

Kush është refugjat?

Përgjigje

Një refugjat është dikush që nuk mund të kthehet në vendin e tij, sepse ata kanë një frikë të bazuar nga persekutimi atje për arsye race, feje, kombësie, anëtarësi në një grup të caktuar shoqëror ose mendimi politik.

Statusi i refugjatëve është forma e mbrojtjes që u jepet njerëzve që përmbushin përkufizimin e refugjatit.

Pyetje Çfarë është mbrojtja e përkohshme?

Përgjajje Mbrojtja e përkohshme plotëson statusin e refugjatit. Kjo do të thotë që dikush nuk mund të kthehet në vendin e origjinës ose në vendbanimin e përhershëm, sepse ata përballen me një rrezik të vërtetë lëndimi të rëndë. Lëndim i rëndë do të thotë (i) dënimi me vdekje ose ekzekutimi; (ii) tortura ose trajtimi ose dënimi çnjerëzor ose poshtërues; (iii) kërcënimi serioz dhe individual për jetën e një personi ose qytetari për shkak të dhunës pa dallim në një situatë konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm.

Pyetje Çfarë është leja e qëndrimit?

Përgjajje Leja e qëndrimit do të shqyrtohet vetëm nëse gjendet se nuk keni të drejtë për statusin e refugjatit ose mbrojtjen e përkohshme. Në këtë rast Ministri shqyrton nëse do t'ju japë leje qëndrimi në Irlandë për një arsye tjetër, si për shembull prej familjes tuaj ose rrethanave personale.

Ministri do të shqyrtojë faktorë si:

- a. natyrën e lidhjes tuaj me Irlandën, nëse ka;
- b. konsiderata humanitare;
- c. karakteri dhe sjellja juaj brenda Irlandës dhe gjetkë, duke përfshirë çdo dënim penal;
- d. konsideratat e së mirës së përbashkët.

Gjatë shqyrtimit të lejes së qëndrimit, Ministri gjithashtu do të marrë parasysh ndalimin e dëbimit.

Pyetje Çfarë do të thotë ndalimi i dëbimit?

Përgjajje Ky parim nënkupton që Ministri nuk mund të dëbojë ose të kthejë cilindo person, në asnjë mënyrë, në kufirin e një territori ku, sipas mendimit të Ministrit, (a) jeta ose liria e atij personi do të kërcënohet për arsye race, feje, kombësie, anëtarësi në një grup të caktuar ose mendimi politik ose (b) ekziston rreziku serioz që personi t'i nënshtrohet dënimit me vdekje, torturës ose ndonjë trajtimi ose dënimi tjetër çnjerëzor ose poshtërues.

Pyetje Çfarë është “leja e qëndrimit”?

Përgjajje Leja e qëndrimit i referohet një procedure që ishte në fuqi para hyrjes në fuqi të Ligjit për Mbrojtjen Ndërkombëtare 2015. Neni 3 i Ligjit të Imigracionit 1999 përcakton faktorët që ministri do të marrë në konsideratë në marrjen e një vendimi për lejen e qëndrimit. Dispozitat vazhdojnë të zbatohen në rastin e personave, dëbimi i të cilëve është duke u konsideruar dhe të cilët më parë nuk kanë aplikuar për azil. Një numër i vogël i rasteve të përkohshme (shih më lart) do të vazhdojnë të shqyrtohen përmes këtyre procedurave.

Pyetje Çfarë do të thotë të jesh i varur nga kërkesa e prindit për mbrojtje ndërkombëtare?

Përgjajje Kjo do të thotë se vlerësimi i aplikimit për mbrojtje ndërkombëtar të fëmijës së varur do të përfshihet në vlerësimin e kërkesës së prindit të tij/saj dhe mund të varet nga rezultati i tij. Fëmija i varur nuk ka një intervistë të veçantë ose shqyrtim të veçantë të nevojave të tij ose të saj të mbrojtjes. Prindi duhet të përfshijë çfarëdo arsye në procesin e aplikimit se pse fëmija ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe/ose duhet t'i jepet leja e qëndrimit në Irlandë. Është e rëndësishme të mbani mend se fëmijët mund të kenë nevoja shtesë ose të ndryshme

mbrojtjeje nga prindërit e tyre.

Pyetje A mund të aplikoj për mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë nëse jam pa shtetësi?

Përgjigje Po, ju mund të aplikoni për statusin e refugjatit dhe mbrojtjen shtesë në Irlandë nëse jeni pa shtetësi. Aplikimi juaj do të shqyrtohet në lidhje me vendin tuaj të banimit të përhershëm, d.m.th. vendit ku jetoni më parë.

Pyetje Po sikur të kem një paaftësi dhe/ose nevoja të tjera të veçanta?

Përgjigje Ju duhet të informoni IPO sa më shpejt të jetë e mundur për aftësi të kufizuar ose nevoja të tjera të veçanta që mund të keni për intervistën tuaj personale, në mënyrë që IPO, aty ku është e mundur, të mund të plotësojë nevojat tuaja.

Pyetje A mund të anulohet deklarata ime e statusit të refugjatit ose deklarata ime e mbrojtjes shtesë?

Përgjigje Po, deklarata juaj e statusit të refugjatit ose deklarata e mbrojtjes shtesë mund të anulohet në rrethana të caktuara të kufizuara, si p.sh. kur më vonë zbulohet se keni dhënë informata të rreme ose mashtruese gjatë shqyrtimit të kërkesës suaj për mbrojtje ndërkombëtare. Nëse ndodh kjo, do të dërgohet një njoftim me shkrim për propozimin e Ministrit për anulimin e statusit tuaj, duke përfshirë arsyet. Juve do t'ju jepet mundësia për të bërë përfaqësime me shkrim te Ministri në përgjigje brenda 15 ditëve pune nga marrja e njoftimit. Sapo Ministri të vendosë të anulojë statusin tuaj, ju mundeni, brenda 10 ditëve të punës, të apeloni në Gjykatën e Rrethit (Circuit Court) kundër këtij vendimi.

Pyetje Ku do të qëndroj gjatë procedurës së mbrojtjes ndërkombëtare?

Përgjigje Ju do t'ju ofrohet strehim nga Agjencia e Pritjes dhe Integritimit në një qendër të ofrimit direkt, megjithatë nëse keni mjetet tuaja financiare për të akomoduar veten, ju jeni të lirë të jetoni diku tjetër. Sistemi i pritjes udhëhiqet nga S.I. Nr. 230 e Rregulloreve të Komuniteteve Evropiane 2018 (Kushtet e Pritjes).

DHËNIA E STATUSIT TË REFUGJATIT NË HERËN E PARË

Aplikimi për Mbrojtjen Ndërkombëtare

Shqyrtimi dhe rekomandimi i IPO

Rekomandimi i Statusit të Refugjatit

Ministri do të lëshojë një Deklaratë të Statusit të Refugjatëve përveç rastit kur kërkuesi është një kërcënim për sigurinë e shtetit

DHËNIA E MBROJTJES SË PËRKOHSHME NË HERËN E PARË

Aplikimi për Mbrojtjen Ndërkombëtare

Shqyrtimi dhe rekomandimi i IPO

Rekomandohet Mbrojtja e Përkohshme (Subsidiary Protection, SP), por jo Statusi i Refugjatit

Ministri do të lëshojë një Deklaratë të SP (Mbrojtja e Përkohshme, Subsidiary Protection)

Apelimi i Statusit të Refugjatëve në dispozicion vetëm për IPAT.


Apelim i pasuksesshëm: Deklarata e SP (Mbrojtja e Përkohshme, Subsidiary Protection) mbetet në fuqi

Ministri do të lëshojë një Deklaratë të Statusit të Refugjatëve përveç rastit kur kërkuesi është një kërcënim për sigurinë e shtetit. Deklarata e SP (Mbrojtja e Përkohshme, Subsidiary Protection) do të pushojë së qeni në fuqi.

Apelim i suksesshëm


DHËNIA E PTR (LEJA E QËNDRIMIT, PERMISSION TO REMAIN) HERËN E PARË

Aplikimi për Mbrojtjen Ndërkombëtare



REFUZIMI I STATUSIT TË REFUGJATËVE, SP (MBROJTJA E PËRKOHSHME, SUBSIDIARY PROTECTION) DHE PTR (LEJA E QËNDRIMIT, PERMISSION TO REMAIN) NË SHEMBULLIN E PARË

Aplikimi për Mbrojtjen Ndërkombëtare



Keni akoma pyetje lidhur me procedurën e re të vetme ose Ligjin për Mbrojtjen Ndërkombëtare pas leximit të kësaj fletëpalosjeje?

Ju mund të kontaktoni zyrën tonë dhe/ose të pyesni avokatin tuaj.

Zyra Ndërkombëtare e Mbrojtjes Shërbimi Irlandez i Natyralizimit & Imigracionit (International Protection Office Irish Naturalisation & Immigration Service)
79-83 Lower Mount Street,
Dublin 2, D02 ND99
Tel: +353 1 602 8000
Faks: +353 1 602 8122
Email: ipo@justice.ie
www.ipo.gov.ie

Mbrojtja Ndërkombëtare Gjykata e Apelit (International Protection Appeals Tribunal)
6/7 Hanover Street,
Dublin 2, D02 W320
Tel: +353 1 474 8400
Tel lokale: 1890 210 458
Faks: +353 1 474 8410
Email: info@protectionappeals.ie
www.protectionappeals.ie

Irish Naturalisation & Immigration Service
Department of Justice & Equality 13-14
Burgh Quay,
Dublin 2, D02 XK70
Tel: +353 1 616 7700
Tel lokale: 1890 551 500
www.inis.gov.ie

Reception and Integration Agency
P.O. Box 11487, Dublin 2
Tel: +353 1 418 3200
Faks: +353 1 418 3271
Email: RIA_Inbox@justice.ie
www.ria.gov.ie

International Organisation for Migration
116 Lower Baggot Street,
Dublin 2, D02 R252
Tel: +353 1 676 0655
Telefon falas: 1800 406 406
Email: iomdublin@iom.int
www.ireland.iom.int

Legal Aid Board Dublin
48/49 North Brunswick Street,
Georges Lane, Dublin 7
D07 PE0C
Tel: +353 1 646 9600
Faks: +353 1 671 0200
Email: lawcentresmithfield@
legaidboard.ie

Legal Aid Board Galway
9 Francis Street Galway,
H91 NS53
Tel: +353 91 561 650
Faks: +353 91 563 825
Email: galwaylawcentre@
legaidboard.ie

Legal Aid Board Cork
Popes Quay Law Centre,
North Quay House,
Popes Quay, Shandon,
Cork, T23 HV26
Tel: +353 21 4551 686
Faks: +353 21 455 1690
Email: lawcentrecorknorth@
legaidboard.ie

Team for Separated Children Seeking Asylum, Tusla - Child & Family Agency
Sir Patrick Dun's Hospital,
Lower Grand Canal Street,
Dublin 2, D02 P667
Tel: +353 1 647 7000
Faks: +353 1 647 7008
www.tusla.ie

Irish Refugee Council
37 Killarney Street,
Mountjoy, Dublin 1
Tel: +353 1 764 854
Faks: +353 1 672 5927
Email: info@irishrefugeecouncil.ie
www.irishrefugeecouncil.ie

Nasc Ireland
Ferry Lane, Dominic Street, Cork
Tel: +353 21 450 3462
Email: info@nascireland.org
www.nascireland.org

Doras Luimni
Central Buildings 51a,
O'Connell Street,
Limerick, V94 268W
Tel: +353 61 310 328
Email: info@dorasluimni.org
www.dorasluimni.org

Crosscare Refugee Service
2 Sackville Place, Dublin 1
Tel: +353 1 873 2844
Faks: +353 1 872 7003
Email: refugeeservice@crosscare.ie
www.crosscare.ie

SPIRASI
213 North Circular Road,
Phibsborough, Dublin 7
Tel: +353 1 838 9664
ose +353 1 868 3504
Faks: +353 1 882 3547
Email: info@spirasi.ie
www.spirasi.ie

Jesuit Refugee Service Ireland
The Mews, 20 Upper Gardiner St.
Dublin 1.
Tel: +353 1 814 8644
www.jrs.ie

UNHCR
102 Pembroke Road,
Ballsbridge, Dublin 4,
Irlandë.
Tel: + 353 1 6314510
Email: iredu@unhcr.org
www.unhcr.ie

